



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM

Nr.21.date 11.10.2005

Komisioni i Konkurrencës ne mbledhjen e tij te dates 11.10.2005mori ne shqyrtim per relacionin e sekretariait te Autoritetit te Konkurrencës si dhe sqarime e dhena nga perfaqesuesit e shoqerive AMC dhe Vodafon,ne lidhje me hetimin ne sektorin e ekonomise te telefonise se levizshme.Konkretisht hetimi paraprak ne kete sektor per sa i perket faktit te ekzizstences ose jo te abuzimit me poziten dominuese dhe te marrveshjeve te fshehta te shoqerive amc dhe vodafone zoteruese te ketij tregu .

Komisioni i konkurrencës pasi degjoi dhe perfaqesuesit te ketyre shoqerive ne seancen e mbyllur degjimore te dates 03.10.2005 dhe dokumentat e sjella nga palet me 07.10.2005 si dhe pasi beri administrimin e plete te provave sghkresore ne lidhje me kete hetim paraprak

VEREN:

-Se ne tregun e telefonise se levizshme veprojne dy shoqeri te cilat kane nje ndarje te tregut afersisht ne masen 60% per AMC dhe 40% per Vodafonin,(te dhenat e marra sipas deklarimeve ne shtyp te subjekteve te ndryshem publik dhe privat),te cilat qendrojne ne kete treg duopolistik ne nje pozite dominuese gje qe mund ti kaloje keto shoqeri fare mire dhe ne nje abuzim me kete pozite ne treg sidomos persa i perket çmimeve te sherbimeve te ofruara ne nivele te larta.Ne shpjegimet qe kompanite dhane para komisionit te konkurrencës nuk provuan se kjo ndarje tregu eshte rezultat i konkurrencës midis tyre

-Se çmimet e te dyjave shoqerive perkatese per sherbimin e ofruarjane pothuaj ne te njejta shifra te ngurta dhe pa fleksibilitet konkurrues

-Se keta operatore si ne shpjegimet perkatese qe dhane dhe deri me sot nuk provuan lidhjen mes kosos se sherbimit te ofruar prej tyre dhe tarifave te cilat ato ofrojne kete sherbim ne tregun shqiptar mendohet se jane te larta.

-Se nga vete operatoret (dhe ne menyre te vecante nga AMC-ja) nuk u sollen dokumenta shkresore, me te cilat te argumentonin pretendimet e tyre te ngritura ne lidhje me Relacionin e Sekretariatit.

Komisioni i Konkurrences duke cmuar dhe vleresuar faktet dhe provat shkresore te administruara nga te cilat vihen re shenja te kufizimeve te konkurrences ne tregun e Telefonise se Levizshme, bazuar ne nenet 24, shkronja d, dhe 43 te Ligjit Nr. 9121 dt. 28.07.2003 “Per Mbrojtjene Konkurrences “,si dhe nenit 19,pika 1,te Rregullores “Per Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit te Konkurrences “

VENDOSI:

1.Miratimin e propozimit te Sekretariatit te Konkurrences per nisjen e procedures se Hetimit te Thelluar ne Sektorin e Ekonomise se Telefonise se Levizshme ne pergjithesi dhe veçanerisht ne Shoqerite AMC sh.a. dhe Vodaon sh.a,persa i perket ekzistences ose jo te Abuzimit me Poziten Dominuese ose shkelje te tjera te konkurrences ne treg.

2.Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem te ngreje grupin e punes qe do te ndjeke kete hetim te thelluar,brenda 5diteve kalendarike nga data e shpalljes se ketij vendimi.

3.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ANETARET

Franc Zhupa
(_____)

Raimond Cimbi
(_____)

Teuta Shkenza
(_____)

Z/Kryetar

Prof.Asc.Lush PERPALI